

INTERVISTË ME GAZMEN SALIJEVIQIN

Prishtinë | Data: 30 nëntor, 2018

Kohëzgjatja: 99 minuta

Të pranishëm:

1. Gazmen Salijeuiq (I intervistuari)
2. Kaltrina Krasniqi (Intervistuesja)
3. Donjetë Berisha (Kamerë)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Kaltrina Krasniqi: *So tell me more about, about your childhood, where did you grow up and how was your neighborhood, your household, your childhood? [Në gjuhën ang.]* Pra, më trego pak për fëmijërinë tënde, ku je rritur dhe si ishte vendi yt, shtëpia jote, fëmijëria jote?

Gazmen Salijeвиq: Paj, si çdo fëmijëri, që të gjithë e kujtojmë me mall ashtu edhe unë. Disi, u linda viteve të '80-ta, më saktë në vitin '81 më 19 maj në një familje rome me plot fëmijë. Pastaj, ajo fëmijëria ka qenë disi e lumtur, me plot dashuri dhe i kemi kushtuar shumë vëmendje njëri-tjetrit. Kemi qenë shumë, është një thënje këtu tek ne në Kosovë, thonë se paratë dhe fëmijët nuk mjaftojn kurrë. Kështu që përveç asaj që kemi qenë shtatë fëmijë në familje, babai ka punuar në minierën në Kishnicë, në kompleksin e Trepçës. Fëmijërinë e kujtoj me mall, sepse kemi pasur një fëmijëri pa brenga. Familja e madhe me shumë dashuri, vëmendje, nëna e cila është kujdesur për ne dhe është munduar në atë drejtim, ka qenë amvise, është munduar gjithmonë të na drejtojë në rrugën e duhur dhe ai ka qenë qëllimi i saj, të na bëj njerëz të mirë. Dhe na ka mësuar ta ndihmojmë njëri-tjetrin.

Ajo që mua më kujtohet është fëmijëria e hershme, kam qenë si çdo fëmijë pak i pafajshëm, pak sherr. Në disa momente kam qenë fëmijë i mirë, por s'i kam dëgjuar nga prindërit e mi kam qenë fëmijë shumë kureshtar, gjithmonë kam kërkuar diçka, kam hulumtuar, më kujtohet se edhe pse nuk ka pasur shumë emisione, televizione, shumë, shumë programe atëherë ka qenë emisioni "Mbijetesa". Ka qenë një emision për Afrikën, për kafshët dhe kjo më kujtohet. Kur e kujtoj fëmijërinë, më kujtohet fillimisht seriali "Mbijetesa", që ka pasur karakter edukativ. Zgjohesha në mëngjes, diku rreth orës 10:00 të mëngjesit, dhe kam pritur dhe me kureshtje e kam shikuar pastaj kam dalur për të luajtur me shokët. Kjo në njëfarë mënyre ma asocion fëmijërinë.

Kaltrina Krasniqi: Ku keni jetuar?

Gazmen Salijeвиq: Ne kemi jetuar në Graçanicë, kemi pasur shtëpi atje dhe në atë kohë jeta në fshat dhe jeta në përgjithësi në këtë vend ka qenë shumë më e qetë. Kur po them më e qetë nuk e kam fjalën për sigurinë, por thjesht nuk jemi ngutur aq shumë me jetën. Të gjithë ne jemi rritur disi, kemi punuar me qetësi dhe nuk kemi vrapuar pas shumë gjërave. Ka pasur gjëra për të cilat flitet sot, respekt, mirëkuptim ndërmjet njerëzve, tolerancë. Dhe disi Graçanica dhe Prishtina ka qenë e vogël atëherë. Nuk ka qenë aq urbane dhe ndoshta jo aq e zhvilluar. Ka qenë interesante, ka qenë interesante të jetohet, ka qenë interesante të shkosh në Prishtinë, ka qenë interesante të jesh pjesë e

qytetit, të jesh pjesë e jetës, sepse kur e krahasoj jetën e viteve të fundit të '80-tave dhe fillimin e viteve të '90-ta, koha kur unë kam filluar t'i mësoj disa gjëra, jeta e atëhershme ka qenë shumë më e qetë se tani, sot jetohet shumë më zhurmshëm, shumë më fuqishëm se dikur.

Kaltrina Krasniqi: Kur ke ardhur për herë të parë në Prishtinë?

Gazmen Salijeвиq: Unë për arsye se i kam pasur prindërit, gjyshën, unë jam rritur në Prishtinë, pra kam jetuar mjaft gjatë tek gjyshja dhe gjyshi im. Kjo ka qenë ndoshta kur i kam pasur diku pesë-gjashtë vjet. Mua madje më kujtohet pak lumi Prishtevka, sepse e kam pasur një kujtesë të fortë, e di, e di lumin Prishtevka, e di që qyteti është dukur ndryshe, po, po... për Prishtinën më kujtohet ajo që më të moshuarit më kanë treguar, ata kanë ardhur në Prishtinë që të hipnin në shkallët lëvizëse në Gërmi, përkatësisht në shtëpinë e mallrave ku tani është Ministria e Financave apo nuk e di cili institucion gjendet aty. E di që ka qenë e famshme ëmbëltorja "Korzo", dhe njerëzit në Prishtinë e kanë pasur shumë me rëndësi shëtitjen nëpër korzo, dhe uljen në ëmbëltoren "Korzo", me qëllim që të të sheh dikush.

E di që njerëzit kanë folur për atë, për ato dashuritë e para, simpatitë e para, disi është jetuar prapë po them, po kthehem te ajo që thashë në fillim, jeta të cilën e kujtoj para kohës kur jam rritur ka qenë shumë më e qetë, disa pjesë të qytetit, eventualisht po tregoj ku, aty ku tani është Qendra Klinike Universitare, ne atje kemi pasur tokë, ka pasur njerëz që e kanë kultivuar tokën. Mua kjo më kujtohet, urbanizimi i Prishtinës nuk më kujtohet aq, më kujtohet që Prishtina ka qenë një qytet i vogël në jug të shtetit të atëhershëm dhe më kujtohet se njerëzit që kanë udhëtuar për në Maqedoni, Greqi, janë ndalur në Prishtinë, kjo është e tëra.

Kaltrina Krasniqi: *What neighborhood did your grandparents live?* [Në gjuhën ang.] Në cilën lagje kanë jetuar gjyshja dhe gjyshi?

Gazmen Salijeвиq: *My grand* [Në gjuhën ang.], prindërit e mi, gjyshi dhe gjyshja ime, kanë jetuar, në këtë lagje {*tregon drejtimin*} ku, pikërisht gjendemi, në parim është kjo shkolla {*tregon drejtimin*} më duket se është quajtur "Aca Marović" më parë, para luftës. Shkolla që gjendet këtu mbrapa...

Kaltrina Krasniqi: Meto Bajraktari?

Gazmen Salijeвиq: Meto Bajraktari. Por unë jam rritur ndërmjet, ndërmjet kësaj pjese të qytetit, pra ku tani është Tophanja, kështu quhet kjo pjesë e qytetit, dhe Ulpianës më saktësisht te Kurrizi. Shoqëria ime, miqtë, disa simpati të para, daljet e para, ai tuneli përfundi, disa kafiteri që atëherë kanë punuar, disa vende ku kemi blerë byrek. Këto janë ato gjëra që unë i kujtoj. Pastaj kemi luajtur futboll mendoj se është quajtur "25 Maji" lokacioni këtu diku, ku tani është Kryqi Kuq Ndërkombëtarë në Prishtinë, ku janë semaforët, aty kemi luajtur futboll. Kjo pjesë e qytetit ku kanë jetuar gjyshja dhe gjyshi im, ka qenë kryesisht pjesa e qetë e qytetit, tani aty ka shumë ndërtesa, shumë vende të reja, disi mund të them që të rritem në Prishtinë ka qenë, ka qenë interesante.

Të paktën për mua, sepse unë tani besoj se Prishtina ka jetë kulturore, më parë janë marrë me kulturë për shkak të dashurisë ndaj saj, nëse mund të them kështu. Dhe me rritjen time këtu tek gjyshja dhe gjyshi, unë në fëmijërinë time të hershme kam qenë kureshtar për jetën kulturore të Prishtinës, pas disa koncerteve, ngjarjeve kulturore, disi prapë po them Prishtina ka qenë qytet i vogël, por qytet që ka pasur shpirt dhe i cili disi ka ditur si të jetoj. Me siguri edhe tash jetohet dhe ka shpirt por ky shpirt është shumë më ndryshe se më parë, para, para nuk e di më shumë se 20 viteve.

Kaltrina Krasniqi: *Where did you go to school?* [Në gjuhën ang.] Në cilën shkollë ke shkuar?

Gazmen Salijeвиq: Unë shkollën fillore e kam përfunduar në Graçanicë, të mesmen këtu në Prishtinë, edhe ditët shkollore janë diçka që, që nuk mund t'i harrojë kurrë, diçka që nuk e di si ta përshkruaj. Unë ndryshe nga vëllezërit dhe motrat e mia, fatkeqësisht dhe shumë të tjerë, me gjeneratën time kemi kaluar një periudhë të vështirë të shkollimit. Kanë qenë vitet e sanksioneve, vitet e embargos, vitet e krizës në këtë vend kur ka qenë vështirë të jetohet. Kur ka qenë vështirë të luftosh për jetë. Më kujtohet një rast kur babai më ka thënë se nuk ka para të më ndihmoj të shkollohem dhe që varet nga unë a do ta vazhdoj shkollimin apo jo por unë kam...

Kaltrina Krasniqi: *Was this primary school or secondary school?* [Në gjuhën ang.] A ka qenë kjo në shkollën fillore apo të mesme?

Gazmen Salijeвиq: *Secondary school* [Në gjuhën ang.], është shkolla e mesme, ka qenë në fillim të viteve të '90-ta viti kur, kur situata fillon të ndryshojë në këtë vend, kur kemi luftë në Slloveni, Kroaci, Bosnje, kur konflikti ngadalë fillon edhe në këtë vend, në Kosovë. Ka qenë vështirë të jetohet dhe pastaj kam dashur më gjithë qejf të vij në Prishtinë, disi më ka lidhur një lloj dashurie për qytetin, për jetën, për shoqërinë, për të gjitha që e krijojnë jetën e një të riu, por mjaft vështirë ka qenë edhe atëherë...

Kaltrina Krasniqi: Ku ke jetuar ti në atë kohë?

Gazmen Salijeвиq: Po te gjyshja dhe gjyshi këtu, tek gjyshja dhe gjyshi sepse ata kanë qenë financiarisht më mirë dhe pastaj për mua ka qenë problem të...

Kaltrina Krasniqi: Ata janë nga ana e nënës?

Gazmen Salijeвиq: Nga, nga ana e nënës, sepse atëherë ka qenë vështirë të udhëtosh, ka qenë vështirë nuk e di, ta blesh atë kartelën mujore për autobus, vështirë ka qenë për paratë e ushqimit, ka qenë vështirë për blerjen e librave. Kur po them ka qenë vështirë, mendoj në aspektin financiar, po, po, shumë pak njerëz kanë punuar në atë kohë. E dimë që rroga nuk ka pasur shumë, prindërit e mi atëherë e kanë humbur punën, babai ka punuar në minierën në Kishnicë, pastaj ka mbetur pa punë {prek mjekrën}. Prindërit e mi në atë kohë kanë shkuar në perëndim për të punuar, ne kemi mbetur vetëm me motrat dhe vëllezërit, kështu që unë një pjesë të fëmijërisë e kam kaluar tek gjyshja dhe gjyshi këtu në qytet dhe...

Kaltrina Krasniqi: Dhe si ka qenë kjo?

Gazmen Salijeвиq: Paj vështirë, për shkak se, se disi edhe unë po them gjenerata ime, dhe njerëzit në moshën prej s'e di, 33 dhe 35 vite, 36, ne disi jemi pjekur para kohe. Unë kur mendoj nganjëherë për veten, dhe njerëzit që janë afërsisht të një moshe si unë, ne jemi rritur dhe jemi bërë njerëz para kohe dhe gjithmonë më vjen vështirë se nuk e kemi shijuar rininë. Kur po them rininë, po llogarisë periudhën e tinejzjerëve nga mosha 16 deri 22, apo 23 vite. Për fat të keq atëherë ka qenë konflikti në Kosovë, ka qenë lufta këtu dhe ne është dashur para kohe të bëhemi njerëz.

Kjo është disi koha ime, e fëmijërisë sime, sepse unë me 14, 15 vite jam bërë anëtarë i shoqërisë kulturore artistike "Roma" në Prishtinë. Kam qenë pjesë e seksionit dramaturgjik ku kam aktruar në

teatrin amator “Roma” në Prishtinë, ku kemi udhëtuar nëpër shtetin e atëhershëm të Jugosllavisë, nëpër festivale, ku jam munduar të kontriboj dhe disi të iki nga ai realitet në botën e teatrit, aktrimit, që ne të shndërrohemi {tregon për kë} në karaktere tjera. Ajo çfarë më ka pëlqyer atëherë ka qenë munda ynë që njerëzve të cilët vijnë në teatër nëpërmjet komedisë t’ia kthejmë buzëqeshjen në fytyrë, sepse po kthehem te ajo se atëherë jeta ka qenë e vështirë, sidomos në këtë vend, kemi pasur migrime konstante, kemi pasur njerëz që jetonin me vështirësi ekonomike, kemi pasur konfliktet e ashtuquajtura, luftën, në, në, në, jashtë Prishtinës, vështirë për jetë ka qenë, pastaj unë në moshën 14, 15, 16 vjeçare jam bërë pjesë e diçkaje që është munduar të krijoj diçka. Atë realitet kam dashur ta pikturoj me ngjyra të kulturës, bashkëjetesës dhe kështu atëherë më ka pëlqyer të punoj në atë drejtim edhe sot e kësaj dite i kujtoj ato festivalet, shfaqjet. E di që atëherë në teatrin “Dodona” në Prishtinë ka qenë premiera e komedisë “Romeo dhe Zhuljeta”, ku ne kemi dashur ta bëjmë veprën e Shekspir, tragjedinë në atë kuptim ta bëjmë në një mënyrë si do ta luanin romët “Romeo dhe Zhuljetën”.

Sepse të gjithë ne në rrethin tonë, në lagjet tona, në rrugët tona e kemi ndonjë Romeo, e kemi ndonjë Zhuljetë, i kemi disa dashuri të ndaluara dhe atëherë ne e kemi përformuar një, një pjesë mjaft të mirë. E kemi luajtur Romeo dhe Zhuljetën, në një kome... {mundohet ta bashkojë} në komedi që nëpërmjet të qeshurave kemi interpretuar dy klasa, dy familje. Sepse në çdo shoqëri ka klasa, kemi dikë që është më i pasur, që vjen nga një grup tjetër. Nuk janë të gjithë {tregon drejtimin} këtu bashkësi por ekzistojnë ato ndarje brenda çdo shoqërie, kështu që ne atëherë e kemi luajtur atë, atë shfaqjen.

Dhe më kujtohet se diku në fund të gushtit, kemi bërë premierën dhe në një moment ka ardhur regjisori dhe shkrimtari i asaj vepre Sebastijani, shoku im i mirë i cili tani jeton në Itali, ka ardhur dhe ka thënë që pas premierës duhet të bëhet menjëherë repriza, sepse njerëzit kanë pritur në rresht jashtë, për, për të blerë biletë dhe kjo është disi e vulosur, që...

Kaltrina Krasniqi: Ky ka qenë një ansambël rom?

Gazmen Salijeviq: Po po po, ne, ne atëherë shfaqjen e kemi bërë në gjuhën rome. I kemi pasur dy familje {me duar sikur bën përfshirjen} do të thotë e kemi marrë konceptin e tërë të “Romeo dhe Zhuljetës”, konfliktin e tyre, por gjithë këtë e kemi bërë përmes prizmit të jetës rome. Përmes prizmit rom, përmes atij, nëse mund të them konfliktit të klasave, konfliktit të klasave ekonomike brenda, brenda, brenda shoqërisë rome dhe në fund të fundit edhe vetë Shekspiri në veprën e vet ka paraqitur përplasje të klasave, konfliktin e pasurive, fuqisë, forcës, dashurisë.

Ne u perpoqëm, ta bëjmë këtë. Edhe unë po them është një vepër e bukur, një moment i bukur i jetës sime dhe jetës së njerëzve që kanë jetuar këtu dikur, kurse është keq se ne gjatë viteve ‘98–‘99 u bëmë të rinjë që luftojnë për jetë.

Kaltrina Krasniqi: Në cilën shkollë të mesme ke shkuar?

Gazmen Salijeviq: Unë e kam mbaruar shkollën e mesme të ekonomisë, këtu, këtu në Prishtinë dhe ...

Kaltrina Krasniqi: Në cilën gjuhë?

Gazmen Salijeviq: Në, në gjuhën serbe, do të thotë se unë gjithë shkollimin, atëherë ka qenë deri në vitin ‘95 e kam mbaruar në gjuhën serbo-kroate, pastaj në gjuhën serbe.

Kaltrina Krasniqi: Ku gjendej shkolla?

Gazmen Salijeвиq: Shkolla gjendej, poshtë kah, kah, tani rrugës që shkohet për Fushë Kosovë. është atje tek shkolla e bujqësisë, përball kazermës. Atëherë ka qenë kazerma e Marshall Titos, tani është kazerma e Adem Jasharit. Dhe ne kemi pasur në një cep që tani quhet Emshir ajo lagje. Kemi pasur aty një byrektore të ndërtuar nga metali, aty kemi shkuar shpesh gjatë kohës së pushimit, kemi blerë byrek ose kifle. Po them jeta në Prishtinë ka qenë interesante sepse, ja kur po kthehem te ushqimi, po menoj për shumë mundësi, shumë restaurante, shumë kafiteri, shumë kafiqa. Mua më kujtohet {tregon mbrapa} që shkolla ekonomike, e bujqësisë, e makinerisë që gjenden në atë pjesë të qytetit, të gjithë njerëzit kanë shkuar aty {tregon drejtimin} për të blerë byrek, atëherë e kemi pasur Sarajevën, përkatësisht Bosnën te, te Kurrizi, ndër Kurriz. Kështu i thoshin atëherë njerëzit, nuk ka pasur shumë vende ku kemundur të shetisësh me shumë dëshirë, tek ato ndërtesat e gjelbërta, njerëzit e kanë quajtur atë pjesë Novi Dom.

Dhe këto kanë qenë disa aventura tona, disa qmenduri të njerëzve të rinjë në qytet.

Kaltrina Krasniqi: *Being a Roma and living in Pristina, how was that then?* [Në gjuhën ang.] Si ka qenë të jesh rom dhe të jetosh në Prishtinë atëherë?

Gazmen Salijeвиq: Paj {gjestikulon me duar} pyetje shumë interesante, sepse disi, si të thëm deri në vitin '99, njerëzit nuk kanë pasur aq nacionalizëm në vete, a i takon grupit të parë, të dytë apo të tretë. Ajo që është shumë me rëndësi është se ne kemi hapësirë për jetesë, dhe në fund ajo që është e rëndësishme sipas psikologjisë njerëzore është se ti ke një punë, je i lirë, mund ta ushqesh familjen tënde dhe në njëfarë mënyre të jetosh i lirë. Dhe ku ta di, ka qenë bukur, ka qenë, nuk ka qenë si sot me nacionalizëm të jesh krenar që je rom, shqiptarë, serb, boshnjak, korean. Mendoj që për njerëzit kjo nuk ak qenë e rëndësishme deri në vitin '99 disi kjo nuk a qenë aq e rëndësishme. E rëndësishme ka qenë që je njeri, që disi, romët kanë qenë pjesë e kësaj shoqërie.

Mu kujtua, atë ditë kur u takuam dhe folëm për atë, se nëse ke dashur të blesh farmerka është dashur të shkosh tek romët në pazar i cili gjendej pas pas pas Boro Ramizit. Në atë platon, ku shqiptarët, kmuniteti shqiptarë është marrë me shitje të duhanit, e kanë mbajtur tregun e gjelbërt, që disi ka pasur kimi ndërmjet njerëzve, ka pasur një farë bashkëjetesë. Prapë po them të jesh rom është disi, në të gjithë kemi jetuar në mënyrë konstante brenda bashkësive tona, por gjithashtu edhe kemi dhënë, i kemi dhënë Kosovës, i kemi dhënë kësaj shoqërisë të them disa përfitime, ndoshta jo në atë kuptim sa i kanë dhënë bashkësitë e tjera, por romët dikuri e kanë gjetur vendin e vet, e kemi pasur vendin tonë në shtetin e madh të atëhershëm {pinë ujë}.

Kaltrina Krasniqi: *How was it living within the community, the Roma community?* [Në gjuhën ang.] Si ka qenë të jetosh brenda bashkësisë, brenda bashkësisë rome?

Gazmen Salijeвиq: {merr frymë thellë dhe zëshëm}

Kaltrina Krasniqi: *Because you, you just said, 'we lived in our own communities, and had our own life in our community, but we did contribute to the...'* [Në gjuhën ang.] Sepse sapo ke thënë, 'Kemi jetuar në bashkësitë tona, dhe e kemi pasur jetën brenda bashkësisë sonë, por edhe kemi dhënë...'

Gazmen Salijeвиq: Paj...

Kaltrina Krasniqi: *Tell me, tell me more about that life because my impression is that we don't know so much about that life.* [Në gjuhën ang.] Më trego, më trego pak më shumë për atë jetën sepse e kam përshtypjen që nuk dimë shumë për atë jetën.

Gazmen Salijeвиq: Definitivisht ke të drejtë kur thua që dikush që nuk është rom, ata që nuk janë rom ne i quajmë “Gagji”, që në përkthim i bie jo-Rom. Kurse “Rom” nëse e përkthejmë, në, në gjuhën tjetër do të thotë “njeri”, përkatësisht në gjuhën rome “rom” do të thotë “njeri” {frymon zëshëm}.

Ajo që duhet të mësohet më shumë rreth romëve është se romët që nga shekulli i X-të e kanë lëshuar Indinë. Kjo është shumë e rëndësishme të dihet, kur flasim për bashkësinë rome. Ne jemi nisur diku nga veriu i Indisë, Pungjabi i sotëm, në kufi me Kashmirin, Indi, Pakistan. Në jemi nisur në shekullin e X-të. Një migrim i madh ka filluar nga India, nuk ka të dhëna të sakta pse romët e kanë lëshuar Indinë, ajo që ekziston nga tregimet, nga disa hulumtime, romët atëbotë e kanë lëshuar për shkak të luftës së madhe. Dhe kjo flet shumë për neve që nëse shikojmë historinë, romët dhe populli rom kurrë nuk kanë luftuar.

Ne jemi popull që e dojmë paqen, që në disa raste të caktuara nuk e mbrojmë as veten, dëshirojmë të jetojmë të lirë, dëshirojmë ta jetojmë jetën në mënyrën tonë, që kurrë si të them popujt e tjerë të botës nuk kemi pasur indikacion që të marrim territore të huaja, të bëjmë okupimin e një populli tjetër, kjo është shumë gjë e rëndësishme. Romët vijnë në Kosovë diku me ardhjen e Perandorisë Osmane këtu, me ardhjen e osmanlinjve dhe romëve, ne e kemi ruajtur atë pikëpamjen e jetës fisnore, mënyrën e jetesës nomade, ku ka qenë shumë e vështirë për juve si shqiptarë apo dikë që është boshnjak, turk, serb, të hyjë në shoqërinë tonë.

Po, po të na njeh dikush disi nuk do ta kuptonte është vështirë, romët, romët janë të tillë, po të bënit hulumtim për ata popujt nomadë, duhet të krijoni besim për të hyrë në atë shoqëri dhe kjo ka qenë kyçe për ne romët sepse në fund të fundit edhe ne jemi fis nomad. Ka qenë, ka qenë lumturi, ka qenë bukur, ka qenë interesante sepse të jetosh brenda bashkësisë rome është një botë në vete, ekzistojnë rregulla, ekzistojnë zakone, ekziston tradita, ekzistojnë zakone që janë specifike për romë. Sigurisht që ato tradita, ato zakone kanë lidhje me, me me popujt e tjerë sepse kur kam folur për ato migrime, ne në njëfarë mënyre kemi mbledhur {e vendos dorën tek goja} më falni, apo kemi marrë nga popujt e tjerë, nga osmanët, nga jermenët, armenët, nuk e di, nga Kaukazi, nga rusët, egjiptianët, indianët, shqiptarët, serbët.

Do të thotë, te romët keni segmente të kulturës, traditës, zakoneve, të të gjitha atyre bashkësive me të cilat ne jemi përzier gjatë udhëtimit tonë. Romët, romët kanë jetuar në atë rrethin e mbyllur, në ato lagje, që tani ekziston një fjalë moderne për to, geto. Ne kemi jetuar në ato lagje, me zakonet tona ku ku ka ekzistuar hierarkia, krejt deri në vitet po them të ‘70-ta, ‘80-ta sikur tek shqiptarët, ne kemi pasur oda, përkatësisht më të moshuarit i kanë zgjidhur problemet brenda bashkësisë. Pra kjo është diçka që ne e kemi marrë nga, nga, nga kultura shqiptare, nga mënyra e jetesës shqiptare, nga Kanuni i Lekë Dukagjinit, ajo, ajo pikëpamja e odës, ku më të moshuarit vendosin brenda, brenda, brenda bashkësisë.

Kurse, nga bashkësitë ortodokse, në, në këtë vend ne i kemi marrë disa festa ortodokse, zakonet, me festimet dhe shënimet në mënyrën pagane. Kjo për mua ka qenë fascinante, kjo për mua ka qenë shumë e quditshme, bashkimi i traditës, paganizmit dhe modernizmit nëse mund të them edhe religjionit. Edhe romët në ato getot e veta, në lagjet e veta kanë jetuar në botën e tyre, ku kanë qenë të

lumtur krahas asaj që infrastruktura, jeta, varfëria, ka qenë e pranishme, por si, si, si ka thënë Cezari, 'Para dhe lojëra që populli të jetë i lumtur'. Romët janë popull që kënaqen me gjëra të vogla.

Do të thotë neve pak na nevojitet për lumturi, disi jemi kënaqur me atë lumturi edhe krahas asaj që disi varfëria ka qenë konstante në jetën tonë, numri i madh i fëmijëve, mungesa e arsimit, jeta e vështirë, madje edhe sot kur kaloj nga lagjet rome, disi vi në përfundim se neve vërtetë na nevojitet pak për të qenë të lumtur. Në fakt kjo vlen për të gjithë popujt e botës, ne, ne, ne shpesh nga romët mund të mësojmë shumë, që jeta nuk është e lumtur nëse ke nuk e di, milion euro apo shtëpi të madhe, ajo çka na nevojitet është buzëqeshja, përqaqimi, muzika e mirë për disponim. Pak ushqim të mirë, familja e madhe, kjo është ajo që e bën jetën të lumtur dhe këtë e kanë pasur romët.

Ne nuk kemi pasur shumë para, kemi pasur pak ushqim, muzikë të mirë dhe familje të madhe.

Kaltrina Krasniqi: I cilit fis je ti?

Gazmen Salijeвиq: Këtë po pyes edhe unë, sepse, sepse romët janë bashkësi e madhe fisnore, Kaltrinë unë ty ta kam shpjeguar që simbol i romëve është rrota, ne e kemi flamurin me ngjyrën e kaltër dhe të gjelbër dhe në mes e ka një rrotë.

Kaltrina Krasniqi: Çfarë kuptimi ka?

Gazmen Salijeвиq: Ngjyra e kaltërt simbolizon qiellin, ngjyra e gjelbërt simbolizon barin, rrota simbolizon fiset dhe udhëtimet. Sepse romët kanë besuar se qielli është udhërrëfyese i tyre, bari është gjithmonë vendi ku mund ta mbështesin kokën gjatë udhëtimit. Gjelbërimi disi simbolizon pastërtinë, simbolizon jetën, natyrën dhe rrota i ka 16 këmbëza, janë 16 fise që kanë filluar udhëtimin nga India dhe kanë udhëtuar sot, përkatësisht para luftës dhe sot në Kosovë i keni Arlitë, Buburgjitë, përkatësisht kovaçët, i keni Gurbetët, Muhaxherët, këto janë përafërsisht katër bashkësi të mëdha fisnore që kanë jetuar në këtë vend.

Kurse, nëpër, nëpër Rumani, Serbi i keni Meçkarët, Çergarët, Uzharët. Uzharët kanë jetuar edhe para luftës. Uzhari është personi që bën litar nga fijet, tani i kemi Sitarët, romët që kanë bërë sita dhe do të thotë kemi romë që kanë qenë specifikisht të zotë në ndonjë segment të jetës. Kemi pasur atëherë në Kosovë, por po them në fillim kanë jetuar, ata katër fiset më dominante. Gurbetët kanë qenë bashkësi që janë njohur si tregtarë, si njerëz, që, që kanë qenë të zotë për tregti. Dhe Buburgjitë apo ata kovaçët janë njerëz që janë të zotë me përpunim të metalit prandaj ata kryesisht i kanë mbajtur farkëtaritë para luftës, të themi edhe në Prishtinë dhe në qytete të tjera në Kosovë dhe tani nuk e di a ekziston ndonjë farkëtarë këtu në, në, në Prishtinë.

Para luftës disi, ata njerëz kanë jetuar nga ajo, janë zanate, dhe janë, janë zanate që janë bartur brez pas brezi, nga babai tek i biri, nga, nga gjyshi tek nipi. Do të thotë, unë vi nga fisi Arlijëve. Dhe Arlitë flasin me një dialekt tjetër nga Gurbetët, dialekt tjetër nga nga Buburgjitë, por çelsi i gjuhës rome është që ne ndërmjet vete kuptohemi. Do të thotë është vetëm dallimi tek dialekti sikur dialekti gegë dhe toskë. Por në princip ekziston komunikimi, ekziston mirëkuptimi, por pasi që me pyetët lidhur me këtë, për ato fiset të themi para luftës, para vitit '99 {e kruan kokën} këtu është disi, mendoj se kjo është e zakonshme për atë lloj të jetës fisnore, për atë, funksionim fisnor, për atë mënyrë të jetesës fisnore, ndoshta kjo nuk është vetëm tek romët, që, që, nuk ka qenë e dëshiruar që të përzihen fiset.

Kur, kur, kur po them përzierja e fiseve e kam fjalën, për ekzistim të martesave ndërmjet njërit dhe tjetrit fis.

Kaltrina Krasniqi: *Why?* [Në gjuhën ang.] Përse?

Gazmen Salijeвиq: Janë disa dallime, janë disa, janë disa ekonomike dhe jo fetare, janë disa {hap duart} si t'ju spjegojë, janë disa tendenca të fiseve, janë zakonet që fiset i kanë përcaktuar, unë si pjesëtarë i një fisi nuk duhet që, që, që, që të përzihem dhe të bashkëpunoj me fiset tjera, edhe pse ne jemi një fis i madh, një bashkësi e madhe, ekzistimi i një populli të madh. Kanë ekzistuar ato rregullat e pashkruara, *unwritten rules* [Në gjuhën ang.] siç thonë anglezët, dhe kjo është nëse, nëse, nëse prapë po them t'i analizosh fiset, bashkësitë fisnore, madje besoj edhe tek popujt e mëdhenj siç janë shqiptarët, serbët, nuk e di popujt e tjerë në Balkan, malazezët.

Ekzistojnë ato rregullat e pashkruara të fiseve. Ekzistojnë ato zakonet brenda atyre fiseve që para 100-200 viteve të moshuarit i kanë përcaktuar, në njëfarë, njëfarë, njëfarë rrethi të zjarrit, çergës dhe muzikës, në ndonjë, ndonjë odë, ku thjesht është thënë që diçka nuk është e dëshirueshme, do të thotë lejohet por nuk është e dëshirueshme.

Kaltrina Krasniqi: *Would you say it's a class issue?* [Në gjuhën ang.] A do të thoshe se ky është një problem klasor?

Gazmen Salijeвиq: *Yes, it's definitely because,* [Në gjuhën ang.]. Po, definitivisht është, sepse ekziston ajo ndarja klasore, ekziston dallimi ekonomik, ekziston ai financiar, ekziston dallimi në ngjyrën e lëkurës, dallimi në ngjyrën, ngjyrën e dialektit, do të thotë ekzistojnë prapë po them, *unwritten rules* [Në gjuhën ang.], rregulla të pashkruara, që zakonet, ti si Kaltrina unë si Gazmeni mund t'i thyejmë. Do të thotë besoj dikur në kohët e lashta, të lashta që në rast të shkeljeve të tilla, ka pasur dënime, kapasur përjashtim nga fisi, përderisa kovaçët, para vitit '99, dhe tani në disa, disa rrethe më të vogla, në disa {kollitet} vende rurale, jo rrallë shoqërohen dhe jo rrallë martohen, bëjnë lidhje bashkëshortore me antarë të fisit tjetër. Dhe kjo është diçka që edhe nëse sot flasim për një lloj të modernizmit, për një jetë të vogël moderne, të gjithë janë modern, bota ka ndryshuar dhe thjesht ata nuk na dojnë, arlité nuk dëshirojnë që me gurbetët të kenë lidhje familjare, atëherë...

Kaltrina Krasniqi: *Did this ever change? Does this continue to be the...?* [Në gjuhën ang.] A ka ndryshuar kjo? Apo vazhdon e njejta...?

Gazmen Salijeвиq: *It kind of changed.* [Në gjuhën ang.] Nga pak po ndryshon, nga viti '99 po ndryshon nga pak, por ato, ato... ka ndryshuar sepse një numër i madh i romëve e ka lëshuar vendin nga viti '99 pas luftës, është bërë një migrim, numër i madh i romëve është shpërngulur në vendet e regjionit apo në perëndim. Dhe pastaj me daljen nga hapësira e Kosovës, në këtë vend nga pak po ndryshon mentaliteti. Ekzistojnë, ekzistojnë tani ndryshimet e tilla por në disa familje ka ende nga pak, që unë, unë në kohë të lirë e quaj kanun, atë atë që e kemi mësuar nga shqiptarët një lloj zakoni ku, ku babai ende thotë "Jo, jo" ata nuk janë, nuk bën, nuk bën, nuk mundemi ne me ta.

Kaltrina Krasniqi: Da li je, *is it in your opinion to have the father decide?* [Në gjuhën ang.] A mendon se babai duhet të merr vendime?

Gazmen Salijeвиq: {lëviz dorën} *It kind of changed* [Disi ka ndryshuar kjo.] Po ndryshon, po ndryshon, kjo është nuk e di, në vitin '99 kur ka qenë e zakonshme që prindërit, prindërit të vendosin për të birin

se me kë do të martohet, për, për të bijën se me kë do të martohet. Tani kjo nga pak po ndryshon, tani është çdo gjë më ndryshe, ekzistojnë marrëveshjet, ekzistojnë dashuritë e hapura madje edhe para vitit '99 një lloj komunikimi, një lloj pikëpamje e dashurisë së lirë, e jo dashurisë së ndaluar sikur tek "Romeo dhe Zhuljeta" tash jemi më të lirë, [qeshet] tani mund të bëni lidhje publike, tani mund, prapë po them, trendi i modernizimit të botës, disi po vjen edhe tek bashkësia rome.

Nuk është më aq që, që, që prindërit apo babai të merr vendim për të gjitha. Tani ekziston dëshira e vajzës ose dëshira e djalit, e të riut se me kë ai do të martohet, apo e vajzës se me kë dëshiron ajo të martohet, për kë do të martohej. Por po them që ende ka nga pak, nuk ka humbur kjo aq, nuk është aq e përkryer me ndryshime moderne por ka dallime të vogla.

Kaltrina Krasniqi: *When you read about the history of this town, Pristina, it's often said that Pristina has the biggest Roma neighborhoods. [Në gjuhën ang.] Kur lexohet për historinë e këtij qyteti, të Prishtinës, shpesh thuhet se Prishtina i ka lagjet më të mëdha rome.*

Gazmen Salijeвиq: Yes. [Në gjuhën ang.] Po.

Kaltrina Krasniqi: *And also it had, it's one of the first cities to have a first radio programme... [Në gjuhën ang.] Dhe gjithashtu ka qenë njëri nga qytete e para që ka pasur radio programin e parë...*

Gazmen Salijeвиq: Yes. [Në gjuhën ang.] Po.

Kaltrina Krasniqi: *And also the people. Can you talk to me more about this because, I think it is also important for the community itself to have that kind of recognition? [Në gjuhën ang.] Dhe gjithashtu populli. A mund të më tregosh diçka më shumë rreth kësaj, sepse mendoj që është e rëndësishme për vetë bashkësinë që ta ketë një njohje të tillë?*

Gazmen Salijeвиq: Po njerëzit që jetojnë sot në Prishtinë, njerëzit të cilët e përbëjnë, e përbëjnë, e përbëjnë, e përbëjnë këtë shoqëri, duhet të dinë, që edhe nëse për momentin nuk ka numër të madh të romëve në këtë qytet dhe ndoshta njerëzit që i shohim tani nuk janë romë të Kosovës por janë romë të Shqipërisë. Që, që, që sot në Prishtinë i kemi vetëm tre familje rome. Që në bazë të disa statistikave, në bazë të disa numrave, diku rreth 27 mijë romë kanë jetuar në Prishtinë, që ka pasur disa lagje të mëdha ku kanë jetuar romët: është lagja te Parku i Qytetit, rruga është quajtur Moravska, ne e kemi thirr të gjithë lagjen Moravska, atëherë ka qenë unë mendoj rruga me emërtimin "Aca Mrdakoviç".

E gjithë ajo, ajo lagja atje te parku është quajtur Moravska. E kemi pasur edhe një lagje tjetër, Dalmatinska, në fakt rruga është quajtur kështu, por romët, një pjesë e madhe e romëve ka jetuar në Dalmatinska. Ky vend është në, në, në, në, në udhëkryqin ku tash jemi, kjo kafiteri, këto kafiteritë e vogla ku janë semaforët {tregon drejtimin me dorë}. Aty, aty, aty, aty gjithashtu ka jetuar një numër i madh i romëve, atëherë kemi pasur...

Kaltrina Krasniqi: Ajo është, është quajtur Tophane?

Gazmen Salijeвиq: Po, po, atëherë. Aty, pastaj...

Kaltrina Krasniqi: *Can you explain that more vividly, because that neighborhood doesn't exist at all anymore? [Në gjuhën ang.] A mund ta përshkruash më gjallërisht, pasi që ajo lagje nuk ekziston më?*

Gazmen Salijeviq: Fatkeqësisht, ajo lagje nuk ekziston, do të thotë nga ata semaforët, për ata që e dinë, pra nga semaforët e deri te shkolla. Do të thotë është ajo rruga që shkon nga ana e majtë {tregon drejtimin me dorë} tek semaforët, atje ku janë...

Kaltrina Krasniqi: Binarët?

Gazmen Salijeviq: Po, prej binarëve deri te semaforët, binarët, e deri te shkolla, deri te udhëkryqi, udhëkryqi tek Tophanja më saktësisht, aty ku, ku është ajo farë qendra aty. Aty ka qenë një lagje e stërmadhe e romëve, Dalmatinska, dhe aty kanë jetuar romët që kanë qenë të afërt me bashkësinë turke. Sepse në atë lagje ka pasur edhe shumë turk, dhe si rrjedhojë përveç gjuhës rome, romët më të vjetër që kanë jetuar në këtë pjesë të qytetit shpesh kanë folur edhe në gjuhën turke. Një lloj lidhje nga ajo lagje me bashkësinë turke në Prishtinë, ka qenë disi shumë e afërt, shumë, shumë të lidhur dhe ka pasur numër të madh të romëve të arsimuar që kanë jetuar në atë lagje, gjithashtu edhe në lagjen Moravska.

Pastaj, e kemi pasur xhaminë e Llapit, përkatësisht tani Kodra e Trimave, apo si quhet ajo pjesë e lagjes {tregon lart me duar} lart, pastaj e kemi pasur Kolibarskën. Kolibarska është lagje ku tani, vetëm pak të kujtohem {mbulon fytyrën me duar} si quhet tani në gjuhën shqipe, është andej nga, tek Shkolla Teknike...

Kaltrina Krasniqi: *Kolovicë?* [Në gjuhën ang.] Kolovica?

Gazmen Salijeviq: Po, po, në drejtim të Kolovicës do të thotë, ata romët që kanë jetuar atje nëse ju kujtohet para luftës, të cilët e ngisnin atë karrocën e drurit, atë karrocën e stërmadhe të drurit nëpër qytet. Ju bartnin njerëzve mobiljet, ushqimin, gjërat, si të them një lloj taksie e qytetit në atë kohë. Atë që, që tani mund ta shohim nëpër televizione ajo që ndodh në Pakistan, Indi, në ato vendet aziatike me karroca të tilla. Romët, romët që kanë jetuar në ato lagje, në atë lagjen lart në Kolibarska zakonisht kanë jetuar nga kjo punë.

Atëherë e kemi pasur Moravskën, numër i madh i njerëzve, numër i madh i romëve të arsimuar, muzikantë, aktivistë. Atë që ti Kaltrina më pyete, vërtetë viteve të '90-ta në Televizionin e Prishtinës, për herë të parë në botë, jo vetëm në Evropë, për herë të parë në botë është emituar programi në gjuhën rome. Radio Prishtina në atë kohë gjithashtu për herë të parë në gjithë botën fillon emisioni javor në gjuhën rome. Romët e Kosovës, kur më pyetët më herët sa kemi kontribuar edhe pse kemi jetuar në një lloj izolimi, nëse tani e shihni shumë lëvizje të tilla të romëve, organizata në botë, shumë të tilla i kanë njohur romët si bashkësia më e madhe etnike në botë, në Evropë jemi diku rreth dymbëdhjetë milion.

Në masë të madhe romët janë merituar, aktivistët romë që kanë jetuar atëherë, që kanë jetuar atëherë, që atëherë kanë punuar në këtë vend.

Kaltrina Krasniqi: Vërtetë?

Gazmen Salijeviq: Po. Pasi që ajo lëvizja e vitit '71 romët si nacionalitet, si komb janë pranuar në Londër në vitin '71 në kongresin e parë të romëve ku, ku të them, të them është miratuar himni rom dhe flamuri rom. Ku është bërë një lloj i strategjisë, të ruajtjes, promovimit dhe mbrojtjes së romëve si bashkësi minoritare më e madhja në Evropë, sepse romët, krahas çifutëve janë bashkësia që më së

shumti ka pësuar gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pastaj romët që kanë mbijetuar, romët me gjenerata të tëra kanë dashur disi t'i mbrojnë romët nga lufta.

Kanë dashur t'i mbrojnë romët si bashkësi sepse deri tek Lufta e Dytë Botërore, romët kanë qenë si {frymon zëshëm} disi si robër. Pastaj, romët e Kosovës gjatë viteve të '70-ta me romët në Serbi, në Kroaci, në Ballkan, pra, kanë bërë një lloj lëvizje. Por, sidomos pionierët e lëvizjes së romëve në botë gjatë viteve të '70-ta filluan në Kosovë, filluan nga Prishtina, nga Prizreni, nga Mitrovica, nga Gjakova, nga vendet tona të vogla në Kosovë. Falë atyre viteve të '70-ta kur Televizioni i Prishtinës e ka lansuar programin e parë rom, emisioni "Agbunipe" që në përkthim do të thotë "Ardhmëria".

Ne kemi, ne kemi mundur të marrim informata në gjuhën tonë, kemi mundur të dërgojmë mesazh në gjuhën tonë, kemi mundur ta promovojmë kulturën tonë, ta ruajmë gjuhën tonë. Në fund të fundit e gjithë kjo është shënuar nga Prishtina dhe Kosova diku në historinë e atyre organizatave ndërkombëtare, si dikush që i pari e ka bërë të mundur, hajt të them e ka bërë të mundur, i ka dhënë hapësirë bashkësisë rome ta promovoj gjuhën, kulturën, traditën dhe të gjitha ato që e përbën një popull.

Kaltrina Krasniqi: *Did, is this like the beginning of also creation, creation of organized cultural organisations of Roma people?* [Në gjuhën ang.] A është, a është ky fillimi gjithashtu i krijimit, krijimit të organizatave të organizuara kulturore të popullit rom?

Gazmen Salijeviq: Po, po, definitivisht është, është diçka që, që, që prapë po them Lufta e Dytë Botërore i ka mbytur të them ashtu në masë të madhe romët dhe bashkësinë rome. Nazistët kanë pasur qëllim që të na zhdukin, zhdukin, po. Kur flas për gjenocid, është zhdukje. Nazistët janë munduar t'i zhdukin romët, çifutët dhe popujt e tjerë dhe unë me shaka gjatë bisedës me disa të afërm them, shumë është vështirë të zhduken romët. {qeshet} Ne jemi popull i fuqishëm, jemi popull i fortë dhe pastaj gjatë viteve të '70-ta ka filluar iniciativa. E kemi parë që dikush dëshiron të na shkatërrojë, që, që ne si shoqëri si bashkësi të zhdukemi.

Dhe pastaj '70-tave kur ka filluar aktivizmi, e gjithë ajo ka qenë iniciativa që shoqëritë kulturore, lëvizjet kulturore, organizatat rinore, shoqatat krijohen, krijohen me një qëllim - ruajtjen, promovimin e kulturës, gjuhës dhe traditës. Dhe e gjithë kjo falë atyre, ne e kemi kulturën tonë, e kemi gjuhën tonë, e kemi traditën tonë. Kur them e kemi, ne e kemi ruajtur falë tyre, falë atyre ne sot vazhdojmë të punojmë atje ku janë ata, ku ata janë ndalur dhe ajo që njerëzit në Prishtinë, apo njerëzit në Kosovë duhet ta dinë është se duhet ta njohësh fqin tënd. Populli ndërmjet vete do ta akuzoj njëri-tjetrin, do ta drejtoj gishtin kah njëri-tjetri, ku do të thotë se dikush tjetër është fajtor për fatin tonë.

Fatkeqësisht të gjithë ne bartim përgjegjësi për ato që ndodhin dhe për atë që ka ndodhur, dhe të gjithë jemi të përgjegjshëm për atë që do të ndodh. Prishtina pa qytetarët e saj, pa romë, malazezë, kroat, serb, shqiptarë, goranë, boshnjakë, turk nuk është Prishtinë. Dhe, disi kush është prishtinas i vjetër, kush ka jetuar në qytet e dinë afërsisht në cilën lagje kanë jetuar romët, ku kanë jetuar serbët, ku kanë jetuar shqiptarët. Disi romët kanë dhënë një kontribut të vogël në zhvillimin e Prishtinës, promovimit të Prishtinës, ne gjithmonë me krenari edhe në ditët e sotme flasim me krenari që Televizioni i Prishtinës, përkatësisht sot RTK-ja është shtëpia e parë mediale në botë që i ka dhënë hapësirë gjuhës rome.

Dhe mendoj se duhet të jemi më shumë tolerant, duhet më shumë të jepim shanse t'i njoftojmë fqinjët tonë sepse atë që unë e kam mësuar nga përvoja ime personale duke u rritur si fëmijë me tjetër lëkurë,

religjion tjetër, bashkësisë tjetër etnike, më kujtohet që ka pasur paragjykime. Ajo pikëpamje që sot e quajmë diskriminim, trajtimin ndryshe të personit me ngjyrë tjetër të lëkurës, gjinisë, racës, orientimit seksual, çfarëdo qoftë, duhet t'i jepet hapësirë njerëzve, është me rëndësi të njihemi me kulturë tjetër, të mos shikojmë çdo gjë bardh e zi, që, që, që unë sot ndihem i zbrazët se Prishtina nuk ka më romë.

Unë sot po ndjehem i pikëlluar, sot, këto vite sepse mendoj që Prishtina do të dukej më ndryshe me romët. Sepse disi ne jemi, të gjithë ne e kemi jetën tonë, të gjithë ne i kemi tregimet e jetës sonë, secili, secili popull i ka kanunet e veta, zakonet e veta. Por, po them disi ato lagje janë zhdukur. Kjo lagja pas Dalmatinskës plotësisht është zhdukur, sikur të mos ekzistonte kurrë. Lagja e Moravskës gjithashtu, aty kanë mbirë banesat, disa shtëpi të reja. Disi historia, tradita, jeta njerëzve, dokumentet e pashkruara, fotografitë e pashkruara, rrugët, lagjet, lojërat e fëmijëve, uji në mes të rrugëve, të gjitha janë zhdukur, disi të them brenda natës dhe pastaj është bërë bota e re.

Në atë botën e re romët e kanë një hapësirë të veten, por sot romët jetojnë vështirë, kur flas për këtu, në këtë pjesë pjesë të Kosovës ata jetojnë në fshatra, jo në qytet. Dhe prapë po them, nëse unë dua të njihem me shqiptarë unë nuk mund ta bëjë këtë nëse jetoj në Graçanicë, por gjithashtu edhe nëse një shqiptarë apo dikush nga shoqëria shqiptare dëshiron të njihet me një rom, nuk mund ta bëjë këtë sepse romët jetojnë nëpër fshatra, jetojnë në vende jo urbane dhe duke shikuar atë që më pyete Kaltrina, si ka qenë jeta si fëmijë, mendoj që atëherë ka pasur harmoni.

Ka qenë një marrëdhënie më e shëndosh ndërmjet njerëzve ndoshta për shkak se nuk ka pasur shumë materializëm, nuk ka pasur shumë nacionalizëm nëse mund të them kështu. Kurse sot gjithçka sillet rreth gjendjes materiale dhe në përkatësinë etnike. Do të thotë, të gjithë ne para luftës, nuk e di, ndërmjet viteve '90-'95 {tregon me dorë} ndoshta edhe gjeneratat që janë që janë pak më të vjetra, që mbajnë në mend më shumë, nuk ka qenë shumë e rëndësishme a je shqiptarë, rom, serb, malazez apo turk që jeton në Prishtinë. Mendoj atëherë ka qenë kjo ndarja klasore, a je prishtinas apo je, {lëviz dorën} apo je, apo je nga fshati, apo je nga ndonjë pjesë tjetër.

Që është normale për, për, për qytetet, normale për një shoqëri por disi ka qenë prapë po them, ka pasur, ka pasur, ka pasur shpirt. Qyteti e ka pasur shpirtin e vet, sot e ka shpirtin e vet, por ai shpirt është i zbrazët pa romët. Kur flas tani për shifra, disa të dhëna tregojnë 27 mijë, unë po them nuk ka nevojë të jenë as 20 mijë, edhe sikur të ishin një qind, një qind njerëz, një qind familje, ky është një numër, ata janë njerëz, janë tregime. Ajo që ju po mundoheni ta bëni. Ajo është jeta e njerëzve, janë kujtimet në, në fëmijërinë tonë, sepse të gjithë ne kur të plakemi mundohemi ta kujtojmë fëmijërinë, lojërat, rritjen, dashuritë e para, simpatitë e para, lojërat nga, nga fëmijëria, nuk e di llastiku apo konopi apo gjerman e partizan.

Çfarë kemi luajtur kauboj dhe indianë. Njeriu gjithmonë me kënaqësi e kujton fëmijërinë dhe fatkeqësisht lufta {pastron fytin} është ajo që ka bërë çfarë ka bërë, që ne kemi tregime të pashkruara, të pa treguara të qytetarëve tonë. Unë e di që, prishtinasve të vjetër ju, ju, ju mungon ajo jetë, fqinjët e tyre, sepse në fund të fundit lufta askujt nuk i ka bërë mirë.

Kaltrina Krasniqi: *When you talk about your past, you talk a lot about tradition and I imagine that once you start having friends from other communities you realize how, how your traditions were different and also when we met last time you, you were actually talking to me about certain traditions which were very interesting to me, that were like particular to your community. [Në gjuhën ang.]*

Kur flet për të kaluarën tënde, flet mjaft për traditën dhe po mendoj se kur fillon të shoqërohesh me bashkësitë e tjera, e kupton që, që traditat e tua kanë qenë të ndryshme dhe gjithashtu kur u takuam herën e kaluar ti, ti më ke treguar për tradita përkatëse që për mua kanë qenë mjaft interesante, që kanë qenë specifike për bashkësinë tënde.

Gazmen Salijeвиq: Po definitivisht, secili popull, secila bashkësi i kanë ato traditat, zakonet, kulturën {vendos dorën në gojë} më falni, mënyrën e jetës dhe duke i njohur bashkësitë e tjera, duke i njohur njerëzit e tjerë, unë e kam parë se sa specifik jemi ne, sa jemi ne të them të ndryshëm, sa jemi ne të veçantë, në në, në atë mënyrën e jetesës sonë, si i kemi zakonet e ndryshme, traditat e ndryshme. Kur flas për këtë mendoj për të gjithë, çdo bashkësi fisnore, {kruan mjekrën} te romët, çdo, çdo shoqëri, çdo familje, çdo familje, çdo bashkësi, e cila ka qenë lart në Moravska apo Dalmatinska apo Tatari apo njerëzit që kanë jetuar në Kolibarska, apo njerëzit që kanë jetuar në fshatra i kanë pasur...

Disi, për mua si fëmijë ato kanë qenë zakone të çuditshme dhe pastaj si i vogël kam filluar të mbledh dhe të shkruaj lidhur me këtë sepse kam menduar disi që kjo, kjo për mua është e çuditshme. Romët që kanë jetuar, një fshat, romët që kanë jetuar në fshatra, romët në Kolibarska e kanë festuar të themi Vasilicën. Vasilica, përkatësisht Shën Vasili sipas besimit ortodoks dhe sipas fesë është festë serbe, shenjtor ortodoks, por romët e kanë festuar Vasilicën. Do të thotë, jo Vasilin, gjini mashkullore, por Vasilicën. Dhe besohet që romët, ekziston një besim, në shkrimet e mia, kanë bërë therjen apo kanë sakrifikuar patën, patat apo patën.

Dhe kur i kam pyetur njerëzit e vjetër përse, nuk e di, pse jo pulën, pse jo diçka tjetër, ndonjë kafshë tjetër, atëherë njerëzit e vjetër me të cilët unë kam folur si tinxher, përse pata, pse ato zakone, ata kanë besuar që, ajo lufta e madhe në Indi, patat kanë fluturuar, i kanë zgjuar romët dhe i kanë shpëtuar nga lufta e madhe dhe nga përmbytja e madhe, uji, dhunës që ka ndodhur atëherë në atë Indi. Dhe si falenderim për shpëtimin e romëve, romët më 13 janar çdo vit i kanë dërguar sakrificën Vasilicës dhe i kanë therur patat.

Pjesa e Dytë

Kaltrina Krasniqi: *You were saying that this was a very specific, this was very specific, the Vasilica was specific, but then are other traditions?* [Në gjuhën ang.] Tregove që kjo është mjaft specifike, është mjaft specifike, Vasilica është specifike, por që gjithashtu kanë edhe tradita tjera?

Gazmen Salijeвиq: *Yeah, of course.* [Në gjuhën ang.] Po, sigurisht.

Kaltrina Krasniqi: *You were telling me about your grandmother, and your relation to other celebrations that were happening.* [Në gjuhën ang.] Ti më ke folur për gjyshën tënde, dhe për marrëdhënjen tënde me festat e tjera që janë mbajtur.

Gazmen Salijeвиq: *Yeah, of course.* [Në gjuhën ang.] Po, sigurisht. Të themi te Vasilica i kemi pasur ato, ato zakonet e çuditshme - t'i mbyllim dritaret, {lëviz dorën} mbyllja, vendosje të mbulesave {sikur të kap diçka me dorë} në dritare po, që të mos shohësh asgjë, çfarë bëjmë tek të tjerët. Them, më kujtohet gjyshja ime e cila, e cila, e cila, e cila ka ardhur nga një fis tjetër, ata kanë qenë kovaçë, Buburgji ata më 2 gusht e kanë festuar Shën Ilinë ose festën kombëtare të maqedonëve Ilinden. Romët kanë besuar, ata që kanë punuar nëpër toka, njerëzit që punojnë me farkëtari, që Shën Ilija

përkatësisht Aligjin, siç e kemi thirrur ne në gjuhën rome, është person i verbër dhe të cilin... njeri rrufepritës, i cili vetëton dhe i cili i ka tri motra që e ruajnë dhe që ai ka karrocë prej zjarri.

Dhe çfarë më ka treguar gjyshja ime është se motrat e tij gjatë vitit, ai në mënyrë konstante i pyet, “Kur është dita ime?” {tregon kah vetja} Në kuptim se kur është festa e tij, në mënyrë që ai të vij në tokë dhe ta djeg tokën dhe pastaj njerëzit janë lutur. I kanë pasur ato tradita të luten dhe që ai, Aligjini të mos e dijë se kur është dita e tij, {lëviz duart} të mos e dijë festën e tij sepse kanë frikë që do të zbret {tregon me dorë poshtë} me atë karrocën e zjarrtë, në, në tokë dhe do ta djeg të gjithë tokën. Pastaj njerëzit gjithashtu, e di që gjyshja ime, dhe kjo është disi e çuditshme. Ajo ka tregonte se çdo 2 gusht {lëviz dorën} bie shi, pa marrë parasysh sa ka diell, atë ditë do të bie shi.

Dhe nëse atë ditë bie shi vitit do të jetë i bereqetshëm, njerëzit kovaçë do t’i nxirrnin, nxirrnin të gjitha mjetet e tyre {lëviz dorën} jashtë, që për shkak të asaj feste thernin delen apo dhinë si falenderim Aligjinit në, në, në, në të mirën. Këto janë tradita, të cilat, të cilat, të cilat njerëzit i kanë festuar, të them në atë mesin rural, përderisa këtu në Prishtinë gjithashtu e kemi pasur një festë të çuditshme, zakon të çuditshëm. Ajo është “bibi” që në në në gjuhën serbe do të thotë “tetka” [tezja]. Bibin e kanë festuar më shumë romët që kanë jetuar nëpër qytete dhe kjo është festuar diku në fund të janarit {lëviz dorën} ndërmjet 22 dhe 25-26 janarit.

Ata si, si falenderim Bibit atë ditë, përkatësisht {lëviz dorën} disa javë më parë e kanë pastruar shtëpinë, e kanë rregulluar, e kanë lyer, çdo gjë kanë rregulluar. Dhe pastaj, asaj Bibit, asaj shenjtores, atë çfarë unë kam bërë, një lloj hulumtimi, ajo është Black Mary, [Në gjuhën ang.] Marija e Zezë që e festojnë spanjollët në Spanjë dhe njerëzit në Andaluzi. Romët besojnë, {lëviz dorën} do të thotë ka ngjasi ndërmjet Marisë së Zezë dhe Bibit. Romët në dritare atë natë kur është nata e festës, {lëviz dorën} atë ditë, do të vendosnin {merr dhe tregon gotën} një gotë ujë, në dritare {kollitet} më falni, krehër, ushqim dhe {lëviz dorën} gjëra të tilla.

Dhe pastaj besonin se ajo do të vinte, kjo është, është diçka që amerikanët e bëjnë me Baba Dimrin, me, me Santa Clause [Në gjuhën ang.] kur vendosin keksha dhe qumësht. Besohej se ajo vinte dhe i vizitonte shtëpitë {lëviz dorën} dhe pasqyrën e vendosnin afër dritares dhe njerëzit besonin se se ajo ka ardhur, është rregulluar, ka pirë ujë... ato janë disa, janë disa tradita pagane që kanë të bëjnë me disa data religjioze, me disa segmente religjioze por plotësisht specifike, të çuditshme, të veçanta, që romët i kanë bërë dhe i kanë shënuar në këto vende. Kur them në këto vende, nuk them vetëm për Kosovën, por madje edhe {lëviz dorën} më gjërë në atë ish shtetin tonë.

Kaltrina Krasniqi: *What about the music? Do you feel that Roma music has affected local music here?* [Në gjuhën ang.] Po muzika? A mendon se muzika rome ka ndikuar në muzikën lokale këtu?

Gazmen Salijeвиq: *Definitely.* [Në gjuhën ang.] {qeshet} Definitivisht po, sepse romët, kanë, kanë, nëse dëgjoni tani sot, sot, sot, sot, sot muzika ka, ka shumë melos rom, ritëm rom në muzikë. Romët kanë, dhënë kontributin e madh të tyre në muzikë përmes, përmes, përmes, përmes segmentit të muzikës, kulturës, vallëzimit, mënyrës së vallëzimit. Të themi mua më kujtohet para luftës në, në, në disa dasma shqiptare, edhe në ato serbe, nuk ke mundur të mos e dëgjosh atë ritmin, ajo që sot quhet *tallava*. Derisa sot mendoj se çdo i dyti këngëtarë ka nga pak atë melosin rom, ajo muzika specifike rome që quhet *tallava* apo atë {lëviz dorën} ritmin rom.

E shihni se para disa viteve e kemi pasur një rom nga Shqipëria i cili ka inçizuar duet me këngëtarin shqiptar nga Shqipëria, ai ka qenë një hit i vërtetë në, në këto vende të Ballkanit, po, po disi romët

{lëviz dorën} e jepin kontributin e vet. Do të thotë, muzika është një pikëpamje e kontributit dhe definitivisht po.

Kaltrina Krasniqi: *Are you religious?* [Në gjuhën ang.] A je ti religjioz?

Gazmen Salijeviq: {merr frymë thellë} Paj, jo të gjithë ne besojmë në diçka dhe dikë dhe të besosh në disa segmente do të thotë të praktikosh atë, atë, atë, atë, atë që e besojmë. Sigurisht që po, të gjithë madje edhe unë besoj në Zot dhe disi na nevojitet një fuqi që do të na udhëheqë në jetë. Romët prapë po them para luftës kanë qenë, kemi shumë paganizëm në vete kështu që besoj në Zot por... {lëviz dorën dhe qesh}

Kaltrina Krasniqi: *Where were you during the war, what happened, where were you?* [Në gjuhën ang.] Ku ke qenë gjatë luftës, çfarë ka ndodhur, ku ke qenë ti?

Gazmen Salijeviq: Si te gjithë të tjerët, kemi ikur nga lufta.

Kaltrina Krasniqi: Ku ke qenë ti?

Gazmen Salijeviq: Kam qenë në Shkup, pastaj kam qenë në në...

Kaltrina Krasniqi: *And when it started?* [Në gjuhën ang.] E kur ka filluar?

Gazmen Salijeviq: *And when it started...* [Në gjuhën ang.] Kur ka filluar, kam qenë në shtëpi {qeshet} nuk e kemi ditur që ka luftë. Disi mendoj se, se, se, se romët nuk kanë besuar edhe sot e kësaj dite, mënyra e jetesës, ndoshta mënyra se si ne jetojmë Kaltrina, ne kurrë as nuk besojmë që, që dikush është i gatshëm të luftojë. Dhe mua më kujtohet ajo ditë. Kam qenë në shkollë, jam kthyer nga shkolla, kam qenë në trening, kam luajtur futboll.

Kaltrina Krasniqi: Ti ke qenë në Prishtinë?

Gazmen Salijeviq: Po, po, po, po. Dhe pastaj kurrsesi nuk kemi besuar që, që, që, që do të krisë lufta. Që do të ketë bombardime, që do të ketë kolona të njerëzve shqiptarë në rrugë që largohen nga shtëpitë e veta. Disi prapë po them ky mentaliteti jonë, mënyra e jetesës, nuk na ka treguar që, që do të ketë konflikt, që do të ketë, që do të ketë skena të tmerrshme, që do të ketë shumë shtëpi të shkatërruara, shumë njerëz të vdekur, shumë njerëz të humbur. Dhe nuk kemi besuar që ajo lufta prapë do të ketë ndikim do ta godiste bashkësinë rome, sepse vitet '99 deri 2000-2001, 99 përqind e romëve e ka lëshuar Kosovën, për shkak të konfliktit, për shkak të pasigurisë, për shkak të shumë situatave të tjera, Romët në atë periudhë i kanë lëshuar këto hapësira.

Unë atëherë kam qenë tinejxherë, kam qenë fëmijë të them ashtu, që nuk ka mundur të besoj se çfarë po ndodh dhe kur të thash që në fillim, ajo rritja e parakohshme, unë atëherë i kam pasur 16-17 vjet. Atëherë jeton në botën e magjisë dhe botën e realitetit, ku një realitet është se, ke luftën para vetes, që ke, që nuk e dinë se çfarë do të ndodh nesër me ty, me familjen tënde. Lufta tregon se çfarë njerëz jemi ne, që çdokush brengoset për veten, që, që është e keqe ndaj njerëzve. Në të njejtën kohë kemi qenë njerëz të rinj, të rinj jemi, edhe tani {qeshet} por atëherë nuk e di, mundohesh që nëpërmjet lojës, nëpërmjet simpatisë ta harrosh realitetin dhe të hysh në një dimenzion të ri.

Me përfundimin e luftës unë kam pasur përparësi sepse ndoshta kam qenë i vetmi që e kam folur gjuhën angleze.

Kaltrina Krasniqi: E ti ke qenë këtu gjatë luftës apo ke?

Gazmen Salijeviq: Jo, jo, nuk kam qenë, nuk kam qenë në, në Kosovë. Kemi qenë refugjatë pastaj jam kthyer gjatë muajit gusht, në mesin e muajit gusht jam kthyer në Kosovë, kur... nga nga Serbia, kur një numër i madh i romëve e kanë lëshuar vendin në jemi kthyer këtu sepse babai im ka qenë i sëmurë dhe nuk ka dashur ta lëshojë Kosovën, dhe as shtëpinë. Në jemi kthyer, unë kam qenë i vetmi në gjithë Graçanicën i cili e ka folur ndoshta gjuhën angleze atëherë, i vetmi në lagjen time, në hapësirën time. Kam filluar të punoj dhe pastaj fillon transformimi i fëmijës në njeri i cili duhet të kujdeset për familjen, i cili duhet të sjellë para që ta ushqejë familjen të cilën gjithashtu duhet ta shkollojë, ta vazhdoj shkollimin.

I cili duhet ta mbrojë popullin e vet i cili ka qenë nëpër kampe, i cili, i cili ka qenë refugjatë, që duhet të jetë disi zëri i vetëm. Rastësisht unë kam qenë ndër dy apo tre romë në Kosovë i cili ka luftuar për të gjithë romët. Dhe pastaj...

Kaltrina Krasniqi: *Before we go to that, because i think that the story of Roma people living in Pristina or Kosovo was never documented and i think it's important for us to talk about it in just a little bit more detail.* [Në gjuhën ang.] Para se të shkojmë aty, sepse mendoj që tregimi i romëve që jetojnë në Prishtinë apo në Kosovë nuk është dokumentuar kurrë dhe mendoj që është e rëndësishme për ne të flasim për këtë me më shumë detaje. Si ke marrë vendim ta lëshosh Prishtinën, si ja ke bërë ti... *Because you just said you were not aware what was happening.* [Në gjuhën ang.] Sepse sapo the që nuk ke qenë i vetëdijshëm çfarë po ndodh.

Gazmen Salijeviq: Jo, ne kemi qenë të vetëdijshëm që, që, që, që është, që është luftë. Që, që, që, që kjo do të ndodh, do të thotë ne kemi...

Kaltrina Krasniqi: Çfarë ka ndodhur nëpër qytet, çka? *Can you just kind of give me, like?* [Në gjuhën ang.] A mund të më tregosh, diçka?

Gazmen Salijeviq: Paj fotografia foografia, e një qyteti të zbrazur, plot policë, plot ushtri, kolona të shqiptarëve në autobusë, vetura, nuk e di trena të cilët i braktisin shtëpitë e tyre. Duke krijuar fotografinë e pasigurisë, Prishtina u shndërrua në një qytet të errët qytet me plot re negativ, shumë ushtri nëpër rrugë. Sepse lufta ka qenë diku jashtë Prishtinës e këtë unë po them gjatë rritjes në Prishtinë ne nuk kemi parë luftë. Do të thotë, lufta ka qenë nëpër mal, nëpër, nëpër nëpër Dukagjin atje, në, në kufi me Shqipërinë. Do të thotë, kurrë se kemi parë luftën këtu në qytet, të paktën jo unë, të paktën jo unë. Ne kemi parë protesta, demonstrata, të gjitha këto, por në vitin '99 krijohej atmosferë e pasigurisë, e pa mbrojtjes dhe pastaj jemi ndier të pasigurtë pastaj në një moment babai im ka marrë vendim që unë me nënën timë, vëllaun tim dhe motrat ta lëshojmë Kosovën. Të shkojmë në Surdulicë, është afër Vranjes, ku kemi jetuar mendoj dy muaj, dy e gjysmë, kështu, deri sa konflikti nuk është kryer.

Pastaj u kthyem këtu, dhe pastaj u kthyem këtu sepse unë...

Kaltrina Krasniqi: Në Prishtinë apo në Graçanicë?

Gazmen Salijeviq: Në Graçanicë. Në Graçanicë sepse në vitin '99 nuk ka qenë e mundur të jesh, të kthehesh në qytet sepse thjesht ka qenë e pasigurtë. Jo vetëm për ne por mendoj edhe për disa shqiptarë ka qenë e pasigurtë të enden, të jetojnë në qytet. E dini si është, nuk është lehtë ta lëshosh shtëpinë tënde. Unë gjithmonë them, sot kur ti më pyet për këtë, kur më pyesin të huajt pse romët kanë ikur, pse romët sot e kësaj dite kërkojnë azil nëpër Evropë, unë them, 'A e dini çfarë? Askush nuk dëshiron ta braktisë shtëpinë e vet'. Pa marrë parasysh a e ke shtëpinë pesë kateshe, a e keni shtëpinë dy katëshe, a e keni një garazhë të vogël ku jetoni, a e keni një dhomë të vogël, të vogël, të vogël ku jetoni me familjen, ajo është e juaja.

Ju ndjeheni të sigurtë dhe bukur në shtëpinë tuaj çfarëdo qoftë ajo shtëpi është e familjes tuaj, është qyteti juaj, është rruga juaj, janë fqinjët tuaj, aty jeni rritur. Aty e keni kaluar jetën dhe askush, pikërisht askush nuk dëshiron ta lëshojë këtë që ka dhe të kërkojë diku tjetër diçka të re. Sado që tingëllon çuditshëm unë besoj se asnjë njeri nuk dëshiron ta lëshojë shtëpinë e vet, pa marrë parasysh a është shqiptar, rom, serb apo kushdo qoftë. Dhe çka do që ne kemi, këdo që e kemi është e vështirë. Unë atëherë e kam parë sa kam qenë refugjatë, që, që, që jeta jashtë shtëpisë tënde është e vështirë.

Të shkosh në tjetër, në tjetër shtet, tjetër qytet, tjetër tjetër vend, ku gjithçka është e panjohur, ku njerëzit nuk te njohin, ku njerëzit të shikojnë ndryshe, ku thjesht ti nuk përputhesh atje. Pastaj, ne kemi marrë vendim të kthehemi, edhe pse unë kam pasur rast të shkoj në Gjermani. Dhe të shkoj si refugjatë, ndoshta sot do të isha atje {qeshet} dhe do të jetoja. Ne kemi marrë vendim të kthehemi këtu, unë atëherë nga shtatori kam filluar të punoj për një organizatë ndërkombëtare në Kosovë dhe disi kur i mendoj ato pamje kur jam kthyer dhe jam ballafaquar me shtëpi të djegura, lagje të shkatërruara, romët që kanë jetuar nëpër kampe, fotografi të romëve, disi, ia kam caktuar vetes si detyrë që duhet t'i mbrojë dhe të luftojë për popullin tim në shumë mënyra.

Sot unë punoj shumë punë, jo vetëm unë por edhe romët e tjerë, por atëherë kemi punuar, çdo gjë që që dikush mund të punoj por nuk e di, lufta për ta ushqyer dikë, deri te lufta për për për për kthim, për barëra, për, për gjithçka kemi punuar dhe kështu...

Kaltrina Krasniqi: *Why wasn't it safe for Roma people to come back to the city?* [Në gjuhën ang.] Pse nuk ka qenë e sigurtë për romët të kthehen në qytet?

Gazmen Salijeviq: Sepse, sepse, sepse, sepse, sepse të them kështu, jo të gjithë shqiptarët por një pjesë e shqiptarëve i ka akuzuar romët që që kanë marrë pjesë në luftë bashkë me serbët. Dhe pastaj sot kur unë flas me shqiptarët, është ajo që ti më ke pyetur për historinë rome, nëse shikojmë historinë, ne kurrë nuk kemi sulmuar, kurrë nuk kemi luftuar, ne jemi thjesht pjesë e sistemit aty ku jetojmë. Do të thotë, romët nuk janë ata që e ngrisin zërin, dhe thonë, "Jo, nuk dua të jem ushtar, nuk dua të jem polic, nuk dua të punoj". Do të thotë, romët disi jetojnë qetë, e kanë respektuar ligjin por gjithashtu është shumë e rëndësishme që, që njerëzit ta dinë që asnjë rom kurrë nuk është akuzuar për një vepër krimi.

Ne ndoshta edhe kemi qenë të detyruar të jemi pjesë e një sistemi, pa dëshirën tonë. Nuk e kemi pasur atë forcën që e kanë pasur shqiptarët të themi, "Jo", dhe pastaj kemi qenë të shënuar, *we were marked* [Në gjuhën ang. - kemi qenë të shënuar] që jemi pjesëtarë të një sistemi dhe pastaj ato lagjet ku kanë jetuar romët janë djegur plotësisht, janë shkatërruar, ku është dërguar ai imazh që romët janë bashkëpunëtorë të serbëve gjatë konfliktit dhe që të jesh rom pas luftës në Prishtinë ka qenë vështirë. Unë shpesh sa kam qenë këtu në qytet, e kam bartur atë pullën e organizatës ku kam punuar, shpesh kam thënë se nuk jam rom, që jam i një vendi tjetër.

Sepse kam pasur frikë të them, “Jam rom”, sepse ndoshta diçka do të më ndodhte. Edhe pse tash imazhi po ndryshon, me siguri ekziston ai, ai paragjykimi, ai, ai imazh i paqartë që romët janë ashtu apo kështu, mendoj se 19 vite pas konfliktit është e qartë që asnjë rom nuk ka bërë asgjë të keqe, që nuk e ka bërë asnjë krim asnjë bashkësisë tjetër, që rastësisht jemi aty ku jemi dhe të gjithë ne duhet të krijojmë kushte që ata njerëz dhe ata që dëshirojnë të kthehen, të kthehen. Të jetojmë afër njëri-tjetrit, ta forcojmë këtë shoqëri, dhe në fund të fundit, të gjithë ne i jepim kontribut Kosovës në një mënyrë apo në mënyrë tjetër.

Dikush kontribon përmes muzikës, dikush përmes kulturës, dikush përmes hulumtimit, dikush nëpërmjet sportit. Kur jam tek sporti, të themi para luftës këtu në Kosovë romët më shumë kanë qenë pjesë e shoqatave të boksit, romët kanë qenë bokserë të famshëm, që kanë fituar medalje në Kosovë, jo vetëm për, për Kosovën, por edhe për Jugosllavinë atëherë. Kanë qenë pjesë e Lojërave Olimpikë, kampionateve botërore, do të thotë ne e kemi dhënë kontributin tonë shoqërisë sonë dhe në një rast para një viti kur kam folur me kryeministrin i kam thënë, mesazhi im jo vetëm për kryeministrin por për të gjithë, ne...

Kaltrina Krasniqi: Kryeministri i Kosovës?

Gazmen Salijeвиq: Po, po. Ne si, si, si shqiptarë si popull shumicë, duhet të, sepse sot ai imazhi që të gjithë ne jepim diçka dikujt, populli shumicë duhet t'i jep përparësi pakicës. Unë jam, unë e kam atë vizionin që populli shumicë ka për obligim që disi të krijojë kushte për bashkësitë më të vogla që të jenë pjesë e shoqërisë. Unë atëherë kryeministrin të Kosovës i kam thënë, “Ndoshta një ditë do ta kemi Majlinda Kelmendin e bashkësisë rome”. Në çka jam totalisht i sigurt sepse gjeneratat që po vijnë, po rriten në shoqëri të re dhe unë besoj se një ditë do të kemi romë të cilët do të jenë pjesë e ekipit të futbollit, që do të jetë pjesë e shoqatave sportive, kulturore, shkencore.

Do të thotë, vetëm duhet të krijojmë hapësirë, të jepim shans sepse kjo është ajo paraqitja, kurrë mos, mos, mos, mos, mos e gjyko librin në bazë të kopertinës por kur e lexon librin, atëherë trego çfarë mendon për librin, njejtë edhe për romët. Nuk guxojmë ta drejtojmë gishtin dhe të themi, “Ata janë të tillë, janë të pa shkolluar, ata nuk dëshirojnë të punojnë, janë bashkëpunor të atij të këtij në konflikt”. Mendoj që duhet të jepim shans ta njohim njëri-tjetrin, që unë kam shans t'i njoh më mirë shqiptarët, kulturën shqiptare, traditën, zakonet. Që gjithashtu edhe shqiptarët të mësojnë diçka të re për kulturën rome, bashkësinë rome, gjuhën rome, muzikën, të të mos na shikojnë përmes prizmit negativ sepse ky është prizmi më i lehtë që dikush e krijon për një bashkësi tjetër.

Dhe me këtë unë besoj, unë them se besoj dhe përpiqem të jem pozitiv që një ditë do të jetë më mirë dhe që ndoshta fëmijët e mi apo fëmijët e romëve të tjerë do të jepin kontribut për Kosovën nënjerin apo segmentin tjetër sepse ne edhe sot madje edhe unë si Gazmen jepi kontribut për këtë shoqëri. Ndoshta jo në kuptimin si e bën Majlinda apo dikush tjetër por të gjithë ne qytetarët jemi pjesë e një *puzzles* [Në gjuhën ang.] të madhe dhe të gjithë ne {kollitet} jepim kontribut por me aq sa mundemi.

Kaltrina Krasniqi: *And what about your family, you created your own family, it was after the war, right?* [Në gjuhën ang.] Po familja jote, ti ke krijuar familjen tënde, pas luftës apo jo?

Gazmen Salijeвиq: Yes, yes. [Në gjuhën ang.] {qeshet} Po, po.

Kaltrina Krasniqi: *Can you tell me more about that?* [Në gjuhën ang.] A mund të më tregosh më shumë lidhur me këtë?

Gazmen Salijeviq: Unë e kam {qeshet} njoftuar gruan time, kemi punuar bashkë në OSCE, dhe jam dashuruar në shikim të parë kështu që unë besoj në dashuri në shikim të parë. I kam dy fëmijë.

Kaltrina Krasniqi: A është gruaja jote rome?

Gazmen Salijeviq: Po, vjen nga një fis tjetër {qeshet}. Po, gruaja ime është rome, i kemi dy fëmijë, e kemi vajzën e cila i ka 14 vjet dhe djalin i cili i ka tetë vjet. E kemi krijuar familjen këtu në Kosovë, mund të them që jemi të lumtur krahas asaj që jeta është e vështirë që, që, që, që, që të gjithë ne dhe jo vetëm unë kemi kemi {merr frymë thellë} probleme për të krijuar kushte më të mira për fëmijët tonë por prapë po them për lumturi nevojitet pak.

Është e nevojshme familja, është i nevojshëm përqafimi, është e nevojshme kafja e mëngjesit me gruan apo bashkëshorten apo burrin. është e nevojshme, dashuria, vlera, të jemi njerëz. Unë shpesh flas për nënë time të ndjerë, e cila na ka msuar të jemi njerëz të mirë. Unë sot po mundohem që edhe fëmijët e mi gjithashtu t'i mësoj që me të vërtetë të jenë njerëz të mirë edhe krijimi i familjes është një krijim më i madh që njeriu mund ta bëjë. Dhe unë po them unë jam njeriu më i lumtur në botë sepse e kam familjen që e dua dhe e cila më do dhe jam shumë krenar me gruan time, me fëmijët e mi, dhe disi ndihma e ndërsjellë, përkrahja është më e rëndësishmja në botë.

Kaltrina Krasniqi: *What does your wife do?* [Në gjuhën ang.] Çfarë bën gruaja e juaj?

Gazmen Salijeviq: Gruaja ime punon si gazetare në televizionin shtetëror, në RTK më shumë se dhjetë vite. Udhëheqë, punon për emisionin që quhet *Yekhipe* [Në gjuhën shqipe] ku, ku, është pjesë e redaksisë rome e cila e cila është krijuar pas luftës në televizionin RTK, në televizionin kombëtarë. Dhe është rome e shkolluar.

Kaltrina Krasniqi: *Is that rare, is that rare?* [Në gjuhën ang.] A është kjo diçka e rrallë, a është e rrallë?

Gazmen Salijeviq: Paj pas luftës ne kemi, ne kemi, ne kemi {kërset gishtat} një lëvizje të mirë të mirë të mirë të mirë dhe pozitive, kemi më shumë e më shumë vajza rome që po shkollohen, përderisa para luftës nuk ka qenë aq, por sot është, është, është, unë me krenari e shoh se si romet e reja përfundojnë fakultet, si, si po shkollohen sepse motorri, fuqia, e secilës shoqëri janë gratë, dhe nënat që na lindin dhe që na edukojnë, që na udhëzojnë në rrugë dhe mendoj se unë jam aq krenar kur shoh se vajzat e reja po e përfundojnë shkollën.

Që në disa hulumtime kemi më shumë vajza të cilat e vijojnë dhe e përfundojnë shkollën, se sa, se sa, se sa djemtë. Kjo është shumë pozitive dhe shumë e mirë që ajo çfarë po bën gruaja ime, atë çfarë po bëjnë gratë tjera, ato fytyrat publike nga jeta jonë na dërgojnë një mesazh të mirë dhe pozitiv, që gruaja mund ta luaj një rol të rëndësishëm në shoqëri patriarkale siç është shoqëria rome, konzervative, shoqëri patriarkale. Dhe se ajo mund të luftojë për pavarësinë e vet, për, për, për jetën e saj në shoqëri {ngritet dhe ulet}.

Kaltrina Krasniqi: *And what did you study?* [Në gjuhën ang.] Çfarë ke studiuar ti?

Gazmen Salijeviq: {merr frymë thellë} Unë e kam përfunduar Fakultetin e Komunikimit Publik, *Public Relations* [Në gjuhën ang.], për momentin i kam regjistruar studimet master për menaxhment. E kam ëndërr që një ditë ta publikoj librin tim, sepse, sepse, sepse shkruaj ndoshta që nga mosha katërmbëdhjetë vjeçare dhe disi e kam gati një roman dhe një libër me poezi. Romani quhet “*Romska crna bajka*” [Përralla e zezë rome], është shkruar në kohën e luftës, gjatë bombardimeve. Flet për, si çdo roman, flet për dashuri, se si dashuria e fiton luftën. E kam poezinë me këngë, kështu që, kaq sa i përket shkollimit.

Në kohë të lirë shkruaj, hulumtoj, kam dëshirë të shënoj gjëra të çuditshme që ndodhin, këngët, zakonet, traditat dhe disi mesazhi im dhe tani edhe për fëmijët e mi dhe fëmijët e tjerë është se me këtë shkollim, arsimim, mund të arrijmë diçka. Unë i kam 37 vjet dhe tani i kam regjistruar studimet, studimet master. Mendoj që kurrë nuk është vonë, mendoj se me krenari mundohem t’i motivoj gjeneratat e reja që duhet të punojmë për vete, duhet të arsimohemi, duhet ta tregojmë veten në kuptimin pozitiv, në një tjetër aspekt.

Shpesh kur, kur flas me njerëzit ata thonë, “Ah romët, ata janë të mirë për muzikë”. Por, nëse unë filloj të këndoj, ju do të iknit sepse unë nuk kam talent për muzikë. Nuk e kam atë talent për muzikë, por e kam talentin për shkrim dhe po them prapë nuk janë të gjithë romët muzikantë, nuk janë të gjithë romët vetëm lypsarë. Kemi romë shumë të talentuar këtu në Kosovë të cilët mund ta jepin kontributin e tyre për shoqërinë kosovare. Kemi romë të shkolluar, kemi rome të reja {pastron fytin} të cilat janë të arsimuara kështu që, besoj në një të ardhme. {merr ujë}

Kaltrina Krasniqi: *It’s very interesting. It’s very interesting that i think in the end of this conversation we will still have to, to talk about prejudice. You just said, “I am not a singer because not every Roma person can sing {smeje se} and that i may be a writer but can you see that in me”, you know what I mean? So, I’m just interested because I doubted that you have lived through a life in Kosovo, especially in this society that is very conservative, and not gone through an experience of prejudice.* [Në gjuhën ang.]

Është shumë interesante. Mendoj se është shumë interesante që në fund të kësaj bisede ne ende duhet të, të flasim për paragjykime. Ti sapo ke thënë, “Unë nuk jam këngëtarë sepse jo çdo rom dinë të këndojë dhe që unë ndoshta jam shkrimtar por a e shihni këtë tek unë”, a e dinë për çfarë e kam fjalën? Pra, unë jam e interesuar sepse dyshoj që e ke jetuar jetën në Kosovë, sidomos në këtë shoqëri që është mjaft konzervative, dhe nuk ke pasur përvojë me paragjykime.

Gazmen Salijeviq: Unë kur flas për këtë them, “Mirë se vini në botën time”. Sepse {merr frymë thellë} kur flasim për diskriminim, paragjykime, unë e kuptoj {hap duart} që thjesht gjenetika e nejrëzve është e tillë. Njerëzit janë të krijuar ashtu që ne kemi paragjykime dhe dëshirojmë të jemi më dominantë se sa të tjerët. Por ta përshtuash diskriminimin apo paragjykimin, Kaltrina, është shumë e vështirë nëse nuk e ke përjetuar atë. Do të thotë unë nuk mund të ju flas njerëzve si po ndjehem nëse ai njeri, apo ai person kurrë nuk ka kaluar nëpër diskriminim, paragjykim, që thonë shqiptarët “*paragjykimi*”.

Sepse unë si një rom aktiv, si dikush që është i arsimuar, dikush që të mos e përdori atë fjalë jam fytyrë publike, dikush që është aktiv në sfera politike, sfera shoqërore, do të thotë shpesh paraqitem, flas, bisedoj. Dhe shpesh mendojnë që di mirë të këndoj, mirë të vallëzojë, sepse jam rom. Shpesh njerëzit para meje flasin që romët nuk dëshirojnë të punojnë, se si janë romët jo punëtorë, se si, të gjitha, të gjitha këto gjërat negative. Që janë gjëra më negative.

Unë përmes punës sime kam pasur rast që njerëzit të më pyesin se si e kam mësuar gjuhën angleze, ku e kam mësuar gjuhën serbe, si është e mundur që di të flas mirë sepse e kanë atë imazhin se romët janë klasa më e ultë e njerëzve që jetojnë. Dhe atëherë shpesh flas për veten dhe këtë ju kam thënë edhe studentëve me të cilët punoj nga bashkësia rome, unë gjatë jetës sime sidomos pas luftës, atëherë jam pjekur si njeri, nëse mund të them ashtu, kam luftuar për dy gjëra.

E para të tregoj që jam njeri, sepse shpesh kur je rom, kur je, kur nuk je aq i fuqishëm, ata nuk të shikojnë si të barabartë, nuk të shohin si njeri atëherë duhet të luftosh, t'ju tregosh se je njeri. Ajo është një gjë. Një gjë tjetër është se, Kaltrina, unë edhe sot e kësaj dite po luftoj të tregoj se jam më i mirë se ata. Në kuptimin, jo që duhesh, por e ke ashtu, një rregull të pashkruar, të pashkruar, *unwritten rules* [Në gjuhën ang. - rregulla të pashkruara] ku ti thjesht për diçka në shoqëri duhet të tregosh se je më i miri, që të fitosh, që të bëhesh i barabartë si të tjerët.

Dhe kjo është një luftë e madhe të cilën unë dhe të tjerët nga bashkësia rome në mënyrë konstante mundohemi ta tregojmë. Në mënyrë konstante mundohemi ta thyejmë atë murin e paragjyqimeve që romët janë hajna, nuk janë lypsarë, nuk janë muzikantë, nuk janë jo punëtorë nuk janë, në mes nesh jo vetëm tek romët, kjo ekziston tek të gjitha shoqëritë, në të gjitha segmentet e njerëzve që, që, që bëjnë diçka negative. Por gjithashtu i keni njerëzit e tjerë të cilët bëjnë gjëra të mira. Unë gjithnjë them se kur flas për atë hapësirën, na jepni neve pak hapësirë sepse është vështirë, është përplasje titanësh.

Lufta me atë paragjykimin sepse shoqëria jonë është përplot me paragjyqime, me shumë konservatizëm, shumë jo tolerancë, që shpesh them për veten, lufta për të treguar që je njeri është shumë e vështirë. Sepse ti e dinë që je njeri por në sytë e të tjerëve ndihet ajo, nuk të trajtojnë si njeri, nuk të trajtojnë si person por të trajtojnë si dikënd që është më i ulët, i nivelit më të ulët, dikush që nuk është i denjë për ata. Pastaj t'i rritesh me atë, lufton me atë dhe është shumë e vështirë.

Kaltrina Krasniqi: *How, how did the life of Roma people change after the war? I mean, you are success story, but I don't believe this was the case with most of Roma people.* [Në gjuhën ang.] Si, si ka ndryshuar jeta e popullit rom pas luftës? Po mendoj, ti ke qenë i suksesshëm, por nuk besoj që ai ka qenë rasti me shumicën e popullit rom.

Gazmen Salijeviq: *It's...* [Në gjuhën ang. - është] Unë, unë e kam pasur atë fat sepse po them, unë edhe pse kam lindur nën yllin e fatit, jam luftëtarë dhe kam dëshirë të të të, të luftojë për, për për të drejtat e mia dhe të drejtat e njerëzve të tjerë dhe disi të mos e jap veten dhe romët e tjerë nuk e kanë atë segmentin e luftimit, disi të të bëhen luftëtarë. Me siguri, ka ndryshime pozitive dhe negative në jetën e romëve pas luftës, por definitivisht numër i madh i romëve ka punuar nëpër fabrika shoqërore, ndërmarrje që kanë funksionuar në Kosovë. Sot fatkeqësisht ato ndërmarrje janë shitur dhe kemi qendra tregtare, kemi dyqane, kështu që asnjë ndërmarrje nuk punon.

Numër shumë i vogël i romëve sot punon, pothuajse me gishta mund të i numërosh t'i gjesh, ju e keni strukturën e tërë 18-19 ministri brenda qeverisë së Kosovës, në nivel qendror, i keni vetëm tre romë që punojnë atje. Dhe atëherë kur flas për këtë betejë në mes titanëve, është vështirë të luftosh me ata titanë, ku ka, nuk e di tetëqind, tetë mijë vende pune, {hap duart} dhe ka vetëm dy romë. Po, po, po, nuk ka ndryshuar shumë, nuk ka edhe aq pozitivitet aty, por prapë po them kur ju me dekada me shekuj, dikush ju shtyp, jetoni vështirë, jetoni me kushte jo njerëzore. Jetoni pa ujë, pa banjo, pa ndoshta ushqim për fëmijët tuaj.

Prapë po them jam i lumtur që po punoj dhe mund t'ia siguroj familjes kërkesat bazike për jetë, sepse besoj se shumë romë sot këtë nuk mund ta kenë për vete, jetojnë prej asaj çfarë gjejnë në rrugë, nga ajo që lypin, gjejnë nëpër kontejnerë dhe kur e sheh këtë imazh, atëherë unë i them vetes që nuk kemi arritur asgjë. Që shumë duhet të punojmë sepse njerëzit duhet të kuptojnë, Kaltrina, a është shqiptarë, serb apo dikush tjetër. Derisa fqinjët tonë pa marrë parasysh se si quhet ai, cilit Zot i lutet, cilës kombësi i takon ai, derisa ne shohim njerëz që lypin në rrugë kërkojnë ushqim nëpër kontejnerë, ne si shoqëri nuk jemi askund.

Kjo është një gjë, nuk është e rëndësishme që Kosova do të hyjë në Bashkimin Evropian, a do të hyjë nesër, por ne duhet t'i krijojmë kushtet për njerëzit tonë, {e vendos dorën tek zemra} për fqinjët tonë, për fëmijët tonë, për të vdekurit tonë {kollitet}, për gjeneratat e ardhshme që po vijnë. Dhe kjo është një gjë që, që, që më brengos tek njerëzit. Jemi bërë egoistë, kemi qenë, jemi bërë të ftohtë. Kur e shohim dikë që po kërkon lëmoshë në rrugë, e kthejmë kokën, nuk na ndjen që qyteti ynë po vdes, që qytetarët e vjetër po shkojnë, që disi...

Prapë po them, që shoqëria duhet të ndryshojë në mënyrë që të ndryshoj edhe populli rom kah më e mira, duhet t'i jepim hapësirë, kur flasim për integrimin, bashkëjetesën, shpesh për Kosovën thuhet se është *multiethnic country* [Në gjuhën ang.] shtet multi-etnik, dhe po them që Kosova është një *artificial multiethnic country* [shtet multi-etnik artificial], nuk është nuk është realiteti i tillë. Ne sot kemi shqiptarë që merren me çështjet shqiptare, serbët që shqetësohen për çështjet serbe, ne kemi romët apo turqit që shqetësohen.

Do të thotë që të gjithë ne jetojmë {lëviz duart} në botë të ndara prandaj po them që është *artificial* [artificiale] kur flas për shoqërinë multi-etnike, që, që shoqëria në përfundim, atë që na mëson përfundimi është të kujdesemi për njëri-tjetrin. Të kujdesemi për njerëzit që kanë mbetur në rrugë, të kujdesemi për njerëzit e varfër, të kujdesemi për të moshuarit, të kujdesemi për të pafuqishmit, dhe ne si shoqëri nuk e bëjmë këtë. Dhe shpesh mundohemi të rritemi si shoqëri, por nuk i kemi bërë gjërat elementare, nuk i kemi kryer detyrat e shtëpisë, të, të, të bëhemi qytetarë më të mirë, të bëhemi njerëz më të mirë.

Dhe kur i marrim për bazë të gjitha këto dhe romët si bashkësi shumë të vogël në Kosovë që ka mbetur, shumë është e vështirë Kaltrinë, sepse pa punë, pa fuqizim ekonomik të bashkësisë, pa arsimim, pa infrastrukturë ju nuk mund ta ndryshoni jetën tuaj. Dhe shpesh flas me njerëzit lidhur me liberalizimin e vizave unë besoj se një numër i madh i romëve do ta lëshojë Kosovën atë moment kur Kosova do ta fitojë liberalizimin e vizave, sepse nuk keni perspektivë që këtu do të jetë më mirë sepse askush deri tani nuk është shqetësuar për juve, sepse, lufta ka mbaruar para 19 viteve që në ende e kemi, e kemi situatën e vështirë në teren dhe kjo është ajo.

Kaltrina Krasniqi: *And this is my last question, since you feel much more comfortable speaking in Serbian language, I suppose also your studies are in Serbian language? Where did you study?* [Në gjuhën ang.] Dhe kjo është pyetja ime e fundit, pasi që po e flisni gjuhën serbe më me lehtësi, po supozoj se edhe studimet i ke kryer në gjuhën serbe? Ku ke studiuar?

Gazmen Salijeviq: Unë kam studiuar në Nish, në Serbi. Ka qenë, ka qenë, pra ka qenë i gjithë, shkollimi im në, në, në, në gjuhën serbe. Shqip kam mësuar dhe flas, tani flas pak më mirë shqip, në vitin 2009 për herë të parë ashtu po them kam punuar në mënyrë direkte me shqiptarë dhe kam filluar ta mësojë gjuhën shqipe. Vet e kam mësuar, kështu që një ditë kam shkuar në kioskë dhe e kam blerë "Koha Ditore" dhe kam thënë, "Do ta lexoj gazetën". Dhe kështu e kam mësuar gjuhën shqipe. Shumë

është e rëndësishme ta dish gjuhën. Unë shpesh ju them njerëzve që duhet ta mësojmë gjuhën e fqinjëve tonë.

Kur po flas për këtë integrimin, shumë njerëz kanë paragjykim, pse unë ta mësojë gjuhën shqipe, unë gjithmonë them, “Kur shkon në Gjermani duhet ta mësosh gjermanishten”. A është ashtu? {lëviz duart} Ashtu është, do të thotë gjithnjë duhet ta mësojmë gjuhën e fqinjëve tonë. Unë e kam përfunduar shkollimin në gjuhën serbe, e flas gjuhën serbe, rome, shqipe, pak gjuhën italiane dhe kjo është e tëra.

Kaltrina Krasniqi: *Thank you very much, this was a very pleasant talk.* [Në gjuhën ang.] Faleminderit shumë, ka qenë bisedë shumë e këndshme.

Gazmen Salijeviq: Ju faleminderit edhe juve!